

Kujdesemi për liqenin, kujdesemi për të ardhmen tonë

Plani i Menaxhimit të
Parkut Natyror “Liqeni i Shkodrës”
Përmbledhje

Photo © Tonin Macaj



Kjo broshurë
financohet pjesërisht
nga Bashkimi Evropian


Liçeni i Shkodrës: natyrë e larmishme, histori shekullor

Liçeni i Shkodrës është liçeni më i madh në Gadishullin e Ballkanit dhe shtrihet në kufirin ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi. Ekosistemi i liçenit dhe zonat ujore, ultësirat dhe formacionet karstike, ushqejnë faunën dhe florën e pasur dhe unike, duke shndërruar atë në një qendër të rëndësishme biodiversiteti në Evropë.

Zonat e shumta arkeologjike, historike dhe kulturore dëshmojnë për trashëgiminë e pasur kulturore të rajonit përreth Liçenit të Shkodrës që në kohët parahistorike. Aktualisht përgjatë basenit të Liçenit të Shkodrës jetojnë rreth 600,000 banorë, 170,000 prej të cilëve në pjesën shqiptare. Aktivitetet ekonomike në këtë rajon, në veçanti bujqësia, peshkimi, pylltaria, turizmi

Rrjeti i Zonave të Mbrojtura në Shqipëri

Parku Natyror "Liçeni i Shkodrës"



Parku Natyror "Liçeni i Shkodrës" është një nga **23 zonat** e mbrojtura të së njëjtës kategori në **Shqipëri**.



Foto © Edoardo Scepi

dhe rekreacioni, janë të lidhura ngushtë me përdorimin e burimeve natyrore të zonës, të cilat ndikojnë në ekosistemin e liçenit. Për të siguruar mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të ekosistemit të liçenit dhe të pasurive natyrore përreth tij, autoritetet Shqiptare dhe Malazeze kanë krijuar zona të mbrojtura, të cilat përfshijnë liçenin dhe pjesë të pellgut të tij.

Një ekosistem ujq kompleks dhe dinamik

► Ekosistemi i Liqenit të Shkodrës varet në mënyrë kritike nga pellgu i tij, si dhe nga zonat përreth tij që mbledhin ujin në liqen. Pellgu i Liqenit të Shkodrës zë një sipërfaqe prej 5,500 km², nga të cilat afërsisht 1,030 km² janë brenda kufirit shqiptar. Nga ana tjetër, nëpërmjet lumit Buna, liqeni është pjesë e basenit të gjerë të Lumit Drin, me një sipërfaqe prej rreth 19,000 km². Lidhja ekologjike me ekosistemet e rrjedhës në Bunë dhe në detin Adriatik ka një rëndësi jetike për shumë lloje peshqish migratorë dhe detarë, ku vlen të përmenden blini, ngjala, qefulli, levreku dhe të tjerë.




Foto © Tonin Macaj

Sipërfaqja e liqenit varion midis 350 km² dhe 570 km², në varësi të stinëve dhe reshjeve, si dhe regjimit të prurjeve të lumit Drin – sa më i ulët niveli i tyre, aq më i madh është shkarkimi nga liqeni. Kur niveli natyral i ujit të liqenit rritet, shumëllojshmëria e habitateve siguron mbijetesën e shumë llojeve të bimëve dhe kafshëve, të cilat varen nga ato për shumim dhe ushqim.

Foto © picturepartners/Shutterstock.com



Ngjala (*Anguilla anguilla*), specie e rrezikuar në mbarë botën



- Korridori i Atlantikut Perëndimor
- Korridori i Adriatikut
- Korridori i Mesdheut dhe Detit të Zi

Shpendë ujqore nga Evropa Qëndrore, Veriore dhe Lindore preferojnë të shtegtojnë drejt zonave të tyre të dimërimit në Detin Mesdhe mbi Ballkan dhe Detin Adriatik, e ashtuquajtur si **Rruga e shtegtit të Adriatikut**.



Dallëndyshja faqebardhë e detit (*Chlidonias hybrida*), specie në rrezik që ngre rregullisht folenë në Liqenin e Shkodrës

Foto © smishonja/Shutterstock.com

Liqeni ushqen rreth 50 lloje peshqish, 37 nga të cilët janë autoktonë, duke përfshirë edhe një numër llojesh endemikë të cilat mund të gjenden vetëm në liqen ose në zona të tjera ujqore të Gadishullit të Ballkanit. Rreth 280 lloje shpendësh janë rregjistruar deri tani në Liqenin e Shkodrës, duke përfshirë shumë lloje të rralla dhe të rrezikuara, të tilla si dallëndyshja faqebardhë e detit, pelikani kaçurrel, dhe çafka e verdhë. Me habitatin e tij të shumëllojshëm dhe larminë e popullsisë së peshqve, Liqeni i Shkodrës përbën një zonë të rëndësishme për shtimin, dimërimin dhe vendpushimin e qindra mijërave shpendëve shtegtarë në rrugën e shtegtit të Adriatikut.

Foto © Porojnicu, Stelian/Shutterstock.com



Pelikani Kaçurrel (*Pelecanus crispus*), i rrezikuar në mbarë botën, ngre folenë në pjesën malazeze të Liqenit të Shkodrës

Kufizimet e përdorimit të burimeve natyrore

► Biodiversiteti dhe burimet natyrore të pasura të Liqenit të Shkodrës kërcënohen nga ndotja, praktikat e paqëndrueshme të përdorimit dhe keqadministrimi i territorit. Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore janë prekur nga ndotja organike e ujërave të zeza të pa trajtuara që derdhen nga fshatrat dhe qytetet përreth liqenit, si dhe nga ndotjet kimike të veprimtarive industriale në Malin e Zi.

Gjatë dekadave të fundit ka patur një rënie të dukshme të gjuetisë së peshkut, si në sasi ashtu edhe në strukturën e llojeve të këtyre specieve. Rezervat e peshkimit në liqen janë zvogëluar nga mbishfrytëzimi, përdorimi i metodave të paligjshme ose të paqëndrueshme, konkurrenca nga specie ekzotike dhe degradimi i habitateve nga ndotja dhe shkatërrimet e bregut të liqenit.

Ndërtime të paligjshme përgjatë bregut të liqenit prishin habitatet natyrore



Foto © Nicola Gilio

Foto © Trofimov Pavel/Shutterstock.com



Blini (*Acipenser sturio*) nuk është regjistruar prej më shumë se 2- vitesh në Liqenin e Shkodrës

KUJDESEMI PËR LIQENIN, KUJDESEMI PËR TË ARDHMEN TONË




Foto © Albanian Ornithological Society

Zogjtë e sapo çelur janë veçanërisht të ndjeshëm ndaj shqetësimeve

Rezervat e peshkimit të llojeve shtegtare në liqen, gjithashtu janë prekur nga peshkimi i paligjshëm dhe praktikat e paqëndrueshme në lumin Buna, në veçanti nga përdorimi i dajlanëve.

Menaxhimi i rezervave të peshkimit në liqen është përkeqësuar më tepër nga mungesa e planifikimit efektiv ndërkuftar.

Gjatë dy dekadave të fundit, gjuetia e paligjshme ka qenë një kërcënim i vazhdueshëm për shpendët ujorë, çka, e kombinuar edhe me ndikime të tjera, si ndryshimet në rezervat ushqimore, cilësia e ujit, klima dhe shqetësimet nga aktivitetet njerëzore, ka zvogëluar numrin e llojeve dhe numrin total të shpendëve në liqen. Zvogëlimi i popullsisë së shpendëve të ujit ka ardhur edhe si pasojë e gjuetisë së pakontrolluar dhe të paqëndrueshme në zonat në afërsi, veçanërisht në Velipojë dhe në grykderdhjen e lumit Buna.

Drejt menaxhimit më efektiv të Liqenit Ndërkufitar të Shkodrës

► Përpjekjet e para për mbrojtjen e biodiversitetit të liqenit dhe burimeve natyrore u ndërmorën në Mal të Zi me shpalljen e Liqenit të Shkodrës Park Kombëtar në vitin 1983. Në vitin 1990 i gjithë Liqeni i Shkodrës u shpall Zonë Ujore e Rëndësisë Ndërkombëtare dhe në vitin 2005, pjesa Shqiptare u shpall Park Natyror, me një sipërfaqe prej 26,535 hektarësh. Pjesa shqiptare e Liqenit të Shkodrës përfshihet gjithashtu në zonën Ramsar “Liqeni i Shkodrës dhe Lumi Buna” të shpallura në 2006.

Përpjekjet drejt një menaxhimi sa më efektiv të biodiversitetit dhe burimeve natyrore të liqenit kanë kulmuar gjatë dekadës së fundit me zhvillimin e planeve të menaxhimit.



Foto © Tonin Macaj

Plani i Menaxhimit për Parkun Natyror të Liqenit të Shkodrës për periudhën 2012-2021, është hartuar në vitin 2012. Përgjegjësia kryesore për zbatimin e planit të menaxhimit është e Administratës Rajonale për Zonat e Mbrojtura (AdZM), me qendër në Shkodër, si pjesë e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM). Puna e administratës udhëhiqet nga vizioni i përcaktuar në Planin e Menaxhimit të Parkut Natyror “Liqeni i Shkodrës”.



“Liqeni i Shkodrës është një ekosistem ndërkufitar i ruajtur mirë, që ofron mundësi për aktivitete zhvillimi të qëndrueshme”

Me qëllim përmbushjen e vizionit të Planit të Menaxhimit, janë identifikuar objektivat e përgjithshme të menaxhimit, si më poshtë:



Përmirësimi i kontrollit dhe menaxhimit të zonës së mbrojtur duke u përqëndruar në kuadrin ligjor dhe institucional, forcimin e kapaciteteve dhe bashkëpunimin ndërkufitar, si edhe në financimin e qëndrueshëm për menaxhimin e zonës së mbrojtur.



Garantimi i cilësisë së ujit dhe nivelit të luhatjeve të sipërfaqes së liqenit të përshtatshme për komunitetet ujore dhe për përdorim publik.



Mbrojtja e biodiversitetit dhe përmirësimi i menaxhimit të botës shtazore, në veçanti habitatet dhe llojet e rëndësishme.



Përmirësimi i mbrojtjes dhe menaxhimit të peizazhit dhe burimeve të trashëgimisë kulturore.



Mbështetje për përdorimin e qëndrueshëm të zonës së liqenit për peshkim, pylltari, bujqësi organike, eko-turizëm, bimë mjekësore, punime artizanale dhe produkte të tjera tradicionale.



Rritja e informimit, promovimit, edukimit dhe forcimi i marrëdhënieve me komunitetin për menaxhimin e liqenit.

Zonimi i Parkut Natyror “Liqeni i Shkodrës”

► Zonimi është një mjet i rëndësishëm në përcaktimin e objektivave dhe kufizimeve për përdorimin e territorit, në një formë të kuptueshme për aktorët dhe përdoruesit e tij. Vendimi i Këshillit të Ministrave 2005 mbi shpalljen e Liqenit të Shkodrës Park Natyror, përcakton këto zona menaxhimi:

- **Zona kryesore:** zona me vlera të mëdha natyrore, të menaxhuara kryesisht për ruajtjen e natyrës
- **Zona për përdorim tradicional:** zona të menaxhuara për mbrojtjen e ekosistemeve dhe burimeve natyrore përmes praktikave tradicionale
- **Zona për përdorim të qëndrueshëm:** zona të menaxhuara për të mbrojtur ekosistemet natyrore dhe përdorimin e burimeve natyrore në mënyrë të qëndrueshme

Plani i menaxhimit përfshin një zonim të rishikuar sipas konceptit të UNESCO-s për Rezervën e Biosferës, që ka si qëllim mbështetjen për arritjen e këtyre objektivave. Ky propozim u rishikua në vitin 2016 nga AdZM e Shkodrës, në konsultim me aktorët vendas në kuadër të projektit “Mbështetje e Menaxhimit të Qëndrueshëm dhe Afatgjatë Ndërkufitar të Liqenit të Shkodrës” dhe sipas objektivave të përcaktuara.

Rregullat që udhëheqin aktivitetin njerëzor në zona të ndryshme të parkut janë si më poshtë:



AKTIVITETI	ZONA		
Kërkime shkencore (me leje)	✓	✓	✓
Ecje (përgjate shtigjeve të markuara)	✓	✓	✓
Shëtitje me kuaj/mushka/gomerë	✓	✓	✓
Mjete motorrike (në rrugë ekzistuese)	✗	✓	✓
Lundrim me varkë/varkë me motor	✗	✓	✓
Kamping (në vende të caktuara)	✗	✓	✓
Ndezje zjarri (në vende të caktuara)	✗	✓	✓
Kapja e kafshëve të egra dhe mbledhja e bimëve	✗	✓	✓
Kullotja (me leje)	✗	✓	✓
Bujqësi tradicionale	✗	✓	✓
Prerje drurësh	✗	✓	✓
Peshkim për tregti/sigurim jetese	✗	✓	✓
Peshkim për rekreacion	✗	✓	✓
Gjueti	✗	✗	✗
Ndërtim infrastrukturash të lehta për turizëm (shtigje, tenda, tabela informuese, etj)	✓	✓	✓
Ndërtime ambientesh të reja turistike	✗	✓	✓
Ndërtime rrugësh te reja	✗	✓	✓
Rikonstruksion të ndërtesave ekzistuese	✓	✓	✓
Rikonstruksion të rrugëve ekzistuese	✓	✓	✓

■ Zonë Kryesore
 ■ Zonë për përdorim tradicional
 ■ Zonë për përdorim të qëndrueshëm

Forcimi i bashkëpunimit

► Angazhimi për një menaxhim të bashkërenduar të zonës së mbrojtur u shfaq më së miri me zhvillimin e planit të ri të zonimit. Në vitin 2015, AdZM e Shkodrës angazhoi shkencëtarë nga Universiteti i Shkodrës dhe peshkatarët, në një proces konsultimi për të rënë dakord mbi rregullat që do të zbatohen në përdorimin e burimeve natyrore në pjesën shqiptare të liqenit. Peshkatarët shqiptarë të liqenit, të organizuar në Organizatën e Menaxhimit të Peshkimit (OMP), kanë një rol të rëndësishëm në përdorimin e qëndrueshëm të burimeve peshkore në liqen. Gjatë procesit ata mësuan konceptin e menaxhimit të zonimit dhe diskutuan mbi variante të ndryshme të ndarjes së zonave, të cilat do të bëjnë të mundur kryerjen e peshkimit për të siguruar jetesën dhe në të njëjtën kohë, ruajtjen e zonave kyçe të riprodhimit të peshqve dhe habitateve të tjera të rëndësishme për botën shtazore të liqenit. Për më tepër, është arritur një marrëveshje midis OMP-së dhe AdZM-së

Shkodër për të bashkuar forcat në zbatimin e një plani të ri zonimi për liqenin. Drejtuesit e AdZM-së Shkodër dhe ata të Parkut Kombëtar të Liqenit të Shkodrës në Malin e Zi, koordinojnë planet e tyre të veprimit për të trajtuar sfida të përbashkëta dhe për të patur një shkëmbim të rregullt informacioni dhe eksperiencash.

AdZM-ja e Shkodrës po përfshin të gjithë aktorët kryesorë në përditësimin e planit të veprimit për zbatimin e planit aktual të menaxhimit për periudhën 2016-2021. Ajo gjithashtu ofron mundësi për përfshirjen dhe mbështetjen e komuniteteve vendore dhe OJF-ve, duke përfshirë edhe OMP-në, për të arritur disa nga objektivat më sfiduese të menaxhimit, në veçanti atë të përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, si peshqit, pyjet, tokën dhe bimët mjekësore.



Plani i Menaxhimit mund të shkarkohet nga faja e internetit:

<http://www.akzm.gov.al>



Foto Flickr© Toma Koma

RAJONI I LIQENIT TE SHKODRES



VIZITONI LIQENIN E SHKODRES

Vendet dhe aktivitetet kryesore

- 1.Fshati Poseljani
- 2.Rijeka Crnojevića
- 3.Žabljak Crnojevića
- 4.Qendra e Vizitorëve të Parkut në Vranjina
- 5.Kolonia e pelikanëve në Pançeva Oka Reserve
- 6.Syri i Sheganit
- 7.Fshati Zogaj
- 8.Maja e Malit Tarabosh
- 9.Shiroka
- 10.Kështjella e Rozafës



Për më shumë informacion ju lutemi vizitoni **faqen Facebook** të Administratës Rajonale për Zonat e Mbrojtura-Shkodër

Administrata e Zonave të Mbrojtura, Shkodër

Informacione shtesë mund të gjeni edhe në faqen e internetit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura
www.akzm.gov.al

Kjo broshurë është botuar si një përpjekje e përbashkët e dy projekteve:

Projekti i financuar nga BE "Forcimi i kapaciteteve kombëtare për ruajtjen e natyrës – përgatitja për rrjetin Natura 2000" i bashkëfinancuar dhe zbatuar nga Agjencia Italiane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (AICS), Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN) dhe Shoqëria Botanike Italiane (SBI) dhe projektin e financuar nga CEPF "Mbështetje e Menaxhimit të Qëndrueshëm dhe Afatgjatë Ndërkufitar të Liqenit të Shkodrës", zbatuar nga Shtëpia e Gjelbër e Malit të Zi, Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) dhe Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN).



Ky botim është realizuar me ndihmën e Bashkimit Evropian.
Përmbajtja e këtyre botimeve është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe në asnjë rast nuk pasqyron pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

**CRITICAL ECOSYSTEM
PARTNERSHIP FUND**